



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr 48 Datë.24/12/2025

**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR
2026-2028 PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 date 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes të PBA të njërive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.8 dt.28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028, udhëzimit plotësues nr.19 dt.10.07.2025 “Për përgatitjen e Programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028” Ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimit nr 7 datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë tavanet përfundimtare për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 përfundimtar.
2. Të miratojë dokumentin përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Këshillin e Qarkut Korçë, të përgatitur sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor(SMBV).
3. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e menaxhimit të programeve, si dhe gjithë administrata e Këshillit të Qarkut.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit.

KRYETARI
Petrika Tollkuçi




Konceptoi O. Beqiraj
Juristi M.Shkurti
Sek. K. Qarkut B. Maço

SHTOJCA 2

Struktura e Dokumentit së Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor, 2026-2028
Relacioni i përgatitjes të Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028,
përfundimtar.

Këshilli i Qarkut Korçë



KËSHILLI I QARKUT KORÇË

PROJEKT DOKUMENTI

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2026 - 2028

Dhjetor 2025

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësisë vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2026-2028 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përkrahet periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. Vështrim i Përgjithshëm i Qarkut (1-2 faqe)

2.1 Situata e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

Me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit grupi i punës, “Për Menaxhimin Strategjik (GMS)”, për hartimin e dokumentit të PBA-së 2026-2028. GMS në punën e tij është mbështetur në kalendarin e hartimit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, i cili është miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut nr. 48 date 23.12.2024. Gjithashtu, me urdhër të Kryetarit u ngrit edhe ekipi i menaxhimit të programit sipas udhëzimeve përkatëse. Sipas udhëzimeve të Ministrisë të Financave, Këshilli i Qarkut Korçë, në vitin 2026 do të fillojë të aplikojë metodologjinë e re në hartimin e buxhetit, dhe për pasojë edhe PBA-ja 2026-2028 do të hartohet sipas kësaj metodologjie ku Qarku do të operojë vetëm me një program buxhetor dhe do të ketë produktet e organizuara sipas funksioneve që ushtron në veprimtarinë e tij. EMP-të për vitin 2025 u ngritën për të gjitha programet që operon Këshilli i Qarkut aktualisht, ndërsa për vitin 2026 e në vazhdim, u ngrit me urdhër të Kryetarit nr. 132 dt.09.12.2025 EMP-ja sipas strukturës të re buxhetore me 1 program të vetëm. Në sistemin SMBV është krijuar edhe EMP-ja për hartimin e projekt buxhetit afat mesëm 2026-2028, faza e tretë, si dhe për hartimin e buxhetit të vitit 2026.

Në zbatim të kalendarit për hartimin e PBA 2026-2028, ekipi për menaxhimin e programeve përgatiti dhe paraqiti për miratim tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm në nivel programi. Këshilli i Qarkut Korçë me Vendim nr. 03 dt.21.03.2025 ka miratuar tavanet përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028. Në këto tavane përfshihen të ardhurat nga granti dhe të ardhurat e veta të njësisë së vetëqeverisjes, pra nuk përfshihen transfertat e kushtëzuara dhe të ardhurat nga trashëgimi. Parashikimi për të ardhurat që do të realizohen nga Këshilli i Qarkut ka ndryshuar. Duke qënë se deri në vitin 2023, të ardhurat e realizuara nga kontributet e bashkive janë në nivele shumë të ulta, gjykoam një tjetër formë për mbledhjen e tyre. Financimet që do të bëjë Këshilli i Qarkut për projekte të ndryshme në të mirë të komunitetit për të gjashta bashkitë pjesë e Qarkut, do të jenë në varësi të kontributit që bashkitë do të derdhin në Qark. Në këtë formë parashikohet të realizohet me sukses zëri i të ardhurave kontribute nga bashkitë.

Në këtë fazë të tretë të PBA-së, tavanet totale të viteve 2027 dhe 2028 kanë vetëm një ndryshim të vogël krahasuar me fazën e dytë. Ndryshim ky që vjen nga ndryshimi i transfertës të pakushtëzuar për këto vite. Ndryshim në të ardhurat e planifikuara nuk kemi dhe për këtë arsye nuk janë miratuar tavane të reja.

Ndërsa për sa i përket vitit 2026, viti 2026 i PBA-së është i njëjtë me buxhetin vjetor 2026. Sigurisht që për vitin 2026 kemi ndryshim të parashikimit të të ardhurave dhe gjithashtu kemi shtuar edhe një pjesë të të ardhurave të trashëguara nga viti 2025. Me më shumë detaje mbi të të ardhurat do të sqarojmë më poshtë.

Këshilli i Qarkut Korçë ka fituar 2 projekte me financim të huaj të cilat do të fillojë ti zbatojë në vitin 2026 dhe ka planifikuar ti shtrijë edhe në vitin 2027. Për këto 2 projekte Këshilli i Qarkut ka planifikuar fonde me kapitull 2 dhe me kapitull 5(trashëgimi). Me kapitull 2 do të planifikohet vetëm pjesa e paraфинancimit. Pjesa tjetër e vleres të projekteve të huaja vijne në formën e rimbursimit të shpenzimeve, pas kryerjes të tyre nga fondet tona buxhetore, për këtë arsye, Këshilli i Qarkut duhet të planifikojë fonde nga buxheti i vet në mënyrë që të mos pengojë zbatimin e projekteve.

Për vitin 2026 tavanet janë shumë më të larta se për vitet 2027 dhe 2028. Në vitin 2026 kemi të përfshirë edhe trashëgimin, i cili është në një vlerë të konsiderueshme, 98 075 160 lekë. Trashëgimi i vitit 2025 është dukshëm në vlera të larta për arsye se në vitin 2025 Këshilli i Qarkut arkëtoi fonde për rimbursimet e projekteve të huaja të cilat kanë përfunduar. 51 607 021 lekë është vlera e këtyre rimbursimeve, të cilat i bëmë pjesë të buxhetit të vitit 2026 që në këtë moment. Pjesa tjetër e trashëgimit do ti shtohet buxhetit të vitit 2026 pas rakordimit përfundimtar me thesarin.

Viti 2027 dhe viti 2028 kanë të përfshira vetëm të ardhurat e planifikuara dhe grantin.

Mbi bazën e vendimeve të mësipërme Grupi i punës ka punuar për përgatitjen e projekt dokumentit përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur puna e GMS :

- *Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligji nr.68 /2017“Per financat e vetqeverisjes vendore”*
- *Ligji nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018. “Për procedurat standarte të Programit Buxhetor afatmesëm te njesive te vetqeverisjes vendore”*
- *Udhëzimi I Ministrisë te Financave dhe Ekonomisë nr. 07 date 25.02.2022 “Nje ndryshim ne udhezimin Nr.23 dt.30/07/2018”Për procedurat standarte të Programit Buxhetor afatmesëm te njesive te vetqeverisjes vendore”*
- *Udhëzimi i Ministrisë se Financave nr. 8 date 28.02.2025 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”*
- *Udhëzimi i Ministrisë se Financave nr. 19 date 10.07.2025 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.47 Date 23.12.2024 “Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2025-2027 për Këshillin e Qarkut”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 03 dt.21.03.2025 “Mbi miratimin e taveveve përgatitore per Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 51 date 23.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit te Keshillit te Qarkut per vitin 2025”*

Situata në të cilën operon Këshilli i Qarkut është një situatë normale. Gjithmonë planifikimi bëhet duke u mbështetur në burimet reale të të ardhurave të vetë institucionit si dhe një menaxhim i mirë i shpenzimeve në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe programeve të planifikuara.

2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat Këshillit të Qarkut

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçë është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore si dhe cdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunim dhe koordinim midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore si dhe bashkëpunimin dhe koordinimin e

politikave midis njësive të qeverisjes vendore të rajonit. Ai ofron partneritet midis të gjithë partnerëve lokalë e rajonalë për pjesëmarje në projekte gjithëpërfshirëse. Ai gjithashtu ofron partneritetin e tij edhe për pjesëmarje në programet ndërkufitare të financuara nga Bashkimi European me synim zhvillimin ekonomik social të Rajonit dhe ritjen e cilësisë të shërbimeve për komunitetin.

Këshilli i Qarkut synon të jetë gjithmonë sa më afër nevojave të qytetarëve dhe të përmbushë misionin e tij në të mirë të komunitetit që përfaqëson.

Për këtë arsye ai ka ndërmarrë një sërë projektesh investimi apo projekte financimi për të gjitha Bashkitë e Qarkut. Këshilli i Qarkut ka qënë dhe do të vazhdojë të jetë mbështetje, brenda kornizave të buxhetit të tij, për të gjitha nismat e Bashkive që i shërbejnë komunitetit, qofshin këto nisma investime apo dhe projekte të tjera sociale, kulturore etj. Për këtë arsye edhe buxheti i vitit 2026 u formulua mbi këto përcaktime. U vu fokusi te projektet që do të kene një impakt rajonal në të gjithë Qarkun dhe që do ti shërbejnë turizmit, kulturës, mbështetjes sociale të kategorive më në nevojë dhe zhvillimit të Rajonit në tërësi. Projektet që Këshilli i Qarkut do të ketë në afatgjatë nuk mund përcaktohen me saktësi, pasi janë gjithmonë në përgjigje të kërkesave dhe evidencimeve që vijnë nga ana e Bashkive të Qarkut.

Gjithashtu Këshilli i Qarkut Korçë është angazhuar maksimalisht edhe në programet ndërkufitare të financuara nga Bashkimi European, që prej vitit 2018. Angazhimi në këto projekte ka sjellë një sërë përfitimesh dhe rritje të cilësisë të shërbimeve për komunitetin, si psh projekti Save Ëater për menaxhimin e ujit të pijshëm. Nëpërmjet këtij projekti u ndërtuan edhe disa ujësjellësa në disa fshatra të Qarkut Korçë. Projekti CLLD i cili fokusohet te trashëgimia kulturore e rajonit dhe zhvillimi i turizmit, projekti Ëaste Rreact për menaxhimin e mbetjeve etj. Këto projekte u mbyllën në fund të vitit 2023, por Këshilli i Qarkut vazhdon të angazhohet maksimalisht për përfitimin e projekteve të tjera të financuara nga Bashkimi European dhe ka aktualisht disa aplikime te cilat presin të finalizohen. Konkretisht ka fituar një projekt të huaj dhe është në përfundim të procesit të finalizimit të marrëveshjes edhe për projektin e dytë. Projektet GST GERA dhe projekti HEALTH4ALL. Në vitin 2026 është futur në buxhet edhe plani me kapitull 2, financim i huaj në lidhje me këto 2 projekte, i cili parashikon pjesën e para financimit. Ndërkohë Këshilli i Qarkut ka planifikuar fonde edhe nga të vetat të cilat ja u ka dedikuar këtyre projekteve nga buxheti i vet, duke qënë se sipas marrëveshjeve të lidhura fondet nga këto projekte vijnë pas kryerjes të shpenzimeve paraprakisht nga fondet buxhetore, dhe pas certifikimit të shpenzimeve donatori disburson fondin.

3. Orientimi Afatgjatë i Këshillit të Qarkut

3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

Qarku i Korçës si njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore, përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga 6 (gjashtë) bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkëta. Kufijtë e qarkut përputhen me kufijtë e 6 (gjashtë) bashkive që e përbëjnë atë, kjo sipas Ligjit Nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë. Qendra e qarkut është në Korçë pjesë përbërëse e Bashkisë Korçë. Bashkitë përbërëse të Qarkut të Korçës janë: - Bashkia e Devollit - Bashkia e Kolonjës - Bashkia e Korçës - Bashkia e Maliqit - Bashkia e Pogradecit - Bashkia e Pustecit.

Këshilli i Qarkut siguron lidhjet e drejtpërdrejta midis nivelit të dytë të qeverisjes vendore (Këshillit të Qarkut) dhe nivelit të parë (Bashkive) nën juridiksionin e tij, duke përfaqësuar në këtë mënyrë unitetin administrativo-territorial dhe interesat e përbashkëta të tyre.

Strategjia e zhvillimit afatgjatë të Qarkut është në varësi të strategjive të Bashkive pjesë e saj. Dukë qënë se Këshilli i Qarkut ka një rol koordinues dhe harmonizues midis politikave të qeverisjes qendrore dhe vendore si dhe midis njësive të qeverisjes vendore të rajonit, synimi është zgjidhja e problematikave të përbashkëta në dobi të komunitetit.

3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsytet dhe Përfituesit

Orientimi afatgjatë i Qarkut do të jetë i lidhur me planet strategjike të Bashkive përbërëse të tij. Konkretisht sfidat kryesore të zhvillimit të Bashkive pjesë e Qarkut lidhen me :

- Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve publike
- Fusha e shërbimeve sociale
- Kultura , sporti dhe shërbimet argëtuese
- Mbrojtja e mjedisit
- Bujqësia dhe zhvillimi rural
- Siguria publike etj.

Këshilli i Qarkut Korçë angazhohet maksimalisht duke ofruar partneritet dhe koordinim midis të gjithë partnerëve lokalë e rajonalë me synim zhvillimin ekonomiko-social të Rajonit dhe rritjen e cilësisë të shërbimeve për komunitetin. Kjo është konkretizuar që në vitin 2024 duke ndërmarrë dhe realizuar një sërë projektesh me karakter social, kulturor, zhvillimor, të cilat kanë pasur një impakt në të gjithë Rajonin tonë. Projektet më të mëdha të investimeve në të cilat do të angazhohet Këshilli i Qarkut konkretizohen në momentin e lidhjes të marrëveshjeve me Bashkitë e Qarkut, pas shqyrtimit të kërkesave të tyre bazuar mbi planet dhe projektet zhvillimore vendore të secilës Bashki pjesë përbërëse të Qarkut. Secila Bashki duhet të dorëzojë në Këshillin e Qarkut planet e tyre zhvillimore vendore.

Për vitin 2026, Këshilli i Qarkut ka parashikuar edhe një fond për realizimin e disa konferencave të cilat do ju vijnë në ndihmë prioriteteve të zhvillimit të Qarkut dhe më vonë ndoshta edhe hartimit të Strategjisë Sektoriale të zhvillimit Rajonal, e cila do i shërbejë të gjithë Rajonit dhe do të jetë në dobi të zhvillimit të tij.

4. BUXHETI AFATMESEM I QARKUT KORÇË 2026-2028

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Qarkut KORÇË gjatë periudhës 2026-2028, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike, nëse janë planifikuar të tillë. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2026-2028, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Qarkut për vitet 2026-2028. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse. Në vijim paraqiten projektet kryesore të investimeve publike të planifikuara nga Qarku.

Për herë të parë, Këshilli i Qarkut Korçë e ka hartuar PBA-në 2026-2028 dhe buxhetin 2026 sipas metodologjisë të re ku ka ndryshuar struktura buxhetore e për pasojë edhe deklarata e politikës të programit. Në vijim, nga viti 2026 dhe më tej, buxheti i Këshillit të Qarkut Korçë përbëhet nga 1 program i vetëm dhe disa produkte që identifikojnë edhe funksionet që ai realisht realizon në ushtrimin e veprimtarisë të tij.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj. Këshilli i Qarkut nuk disponon të dhëna statistikore të këtij tipi.

Tabela 1. Informacion Bazë mbi Qarkun

RAPORTI PBA9: INFORMACION MBI NJVQV/PROGRAMIN

Ne pamundesë kopjimi të tabelave vec e vec, tabelat i bashkengjithen këtij relacioni dhe janë pjese e tij.

4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Qarkut KORÇË në vitet 2026-2028

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Qarkut KORÇË për vitet 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të Ardhurat e Qarkut sipas Burimit

RAPORTI PBA2: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE

Ne pamundesit kopjimi te tabelave vec e vec, tabelat i bashkengjithen ketij relacioni dhe jane pjese e tij.

Në drejtimin e Kryetarit të GMS, grupi i punës ka punuar për planifikimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 mbështetur në:

- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Analizen e realizimit të buxhetit në dy vitet paraardhëse si dhe në realizimin e pritshëm të tij për vitin 2025.
- Rritjen e lejuar të transfertës së pakushtëzuar të parashikuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08 date 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”.
- Programi i aktiviteteve për vitin 2025 për institucionin e Këshillit të Qarkut të lidhura me objektivat e zhvillimit të qeverisjes vendore.
- Parashikimi i pritshëm i realizimit të kontratave për implementimin e Projekteve të fituara me fonde të Bashkimit Europian në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC Greqi – Shqipëri 2021-2027 apo dhe programeve të tjera.
- Normativat e lejuara të shpenzimeve të miratuara me akte ligjore e nënligjore.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 08 date 28.02.2025 si dhe udhëzimit nr.19 dt.10.07.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”, si dhe bazuar në shkresën e ardhur nga Ministria e Financave mbi transfertën e pakushtëzuar të vitit 2026, 2027 dhe 2028, tavanet për transfertën e pakushtëzuar janë planifikuar përkatesisht për vitin 2026, 3.6% më e lartë se në vitin 2025, për vitin 2027 me 2.2% krahasuar me vitin 2026, dhe për vitin 2028 me 2.3% krahasuar me vitin 2027. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shohim se vjen në rritje. Mendojmë se kjo është një rritje relativisht e mirë duke patur parasysh aktivitetet dhe programet e parashikuara për këtë Program Buxhetor Afatmesëm si dhe niveli i ulët i të ardhurave që realizon Këshilli i Qarkut. Transferta e pakushtëzuar kap një peshë të konsiderueshme të buxhetit në total.

Transferta e kushtëzuar nuk është bërë pjesë e PBA-së për vitet 2026, 2027 dhe 2028 duke qënë se ajo nuk mund të parashikohet me saktësi, ndërsa për vitin 2024, te fakti, kemi llogaritur edhe transfertën e kushtëzuar.

Për vitin 2024 dhe 2025, vec transfertës të kushtëzuar të Drejtorisë të Administrimit dhe mbrojtjes të tokës, kemi dhe një transfertë të kushtëzuar që lidhet me fondin social për pagesën e pagave dhe sigurimeve për punonjësit e qendrave të të moshuarve në Bashkitë Korçë, Maliq dhe Pogradec. Këto qendra administrohen nga Bashkia Korçë dhe Misioni Emanuel dhe financohen nga fondi social për mbulimin e pagave dhe sigurimeve të punonjësve. Gjithashtu Këshilli i Qarkut Korçë mbulon një sërë shpenzimesh të tjera sipas nevojave të tyre. Sic e theksuam edhe më lart, transfertat e kushtëzuara nuk janë pjesë e PBA-së.

Të ardhurat e veta përbëhen nga kontributi financiar i bashkive dhe të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që ofron këshilli i qarkut. Aktualisht Këshilli i Qarkut ofron tarifa vetëm nga DAMT dhe shumë rrallë nga arkivi i Urbanistikës. Te ardhurat e veta faktike për vitin 2022 dhe 2023 janë krahasimisht me të ulta sesa fakti i vitit 2024 dhe parashikimet për vitet 2025, 2026, 2027, 2028. Fakti shumë i ulët i realizimit lidhet me mungesën e depozitimit të kontributeve të Bashkive që në njëfarë mënyre e kanë detyrim derdhjen e kontributit për Këshillin e Qarkut. Kjo bëri që në vitin 2024 të përdorej një tjetër arsyetim për planifikimin e këtyre të ardhurave, pra kontributeve të bashkive.

Lidhur me planifikimin e të ardhurave të vetë institucionit nga kontributet e bashkive, grupi i punës ka përdorur një logjikë ndryshe nga më përpara me qëllim rritjen e arkëtimeve nga këto kontribute. Duke qënë se deri tani të ardhurat e realizuara nga kontributet e bashkive janë në nivele shumë të ulta, gjykojmë një tjetër formë për mbledhjen e tyre. Financimet që do të bëjë Këshilli i Qarkut për projekte të ndryshme në të mirë të komunitetit për të gjashta bashkitë pjesë e Qarkut, do të jenë në varësi të kontributit që bashkitë do të derdhin në Qark. Bashkitë që kontribuojnë më shumë, do të përfitojnë më shumë. Në këtë formë parashikohet të realizohet me sukses zëri i të ardhurave kontribute nga bashkitë dhe është parashikuar në një vlerë dukshëm më të lartë se vitet e mëparshme. Fakti i vitit 2024 tregon se arkëtimet nga ky zë janë rritur, por jo sipas pritshmërive. Parashikimi për vitet 2026, 2027 dhe 2028 ka ecur bazuar mbi të njëjtën metodologji. Vëmë re se parashikimi për vitin 2025 për këto të ardhura është më i lartë edhe nga vitet 2026, 2027 dhe 2028 sepse kemi llogaritur këtu edhe pjesën e parealizuar të të ardhurave që priteshin të realizoheshin për vitin 2024, me pretekstin e bashkive se do ja akordonin qarkut në vitin 2025. Kjo mënyrë e mbledhjes të kontributeve të Bashkive u gjykua se do të ishte më frytdhënëse sesa thjesht hartimi i marrëveshjeve me bashkitë për të derdhur kuotat e tyre, pasi kuotat e bashkive kanë qënë gjithmonë problematike për sa i përket arkëtimit. Ndërsa për sa ju përket të ardhurave që Këshilli i Qarkut arkëton nga tarifat, janë parashikuar më të ulta krahasuar me vitin 2023 bazuar në faktin e realizimit të tyre si dhe në shërbimet që ofron DAMT-ja, pasi Qarku arkëton tarifa vetëm nga DAMT-ja dhe shumë rrallë nga arkivi i urbanistikës. Te ardhurat nga tarifat, është e pamundur të parashikohen për vetë natyrën që kanë. Për vitin 2026 këto të ardhura janë parashikuar në të njëjtat nivele si dhe viti 2025. Fakti i realizimit të tyre sa vjen dhe ulët, dhe për të qënë optimistë në parashikime niveli i këtij plani u la i pandryshuar.

Gjithashtu, për vitin 2025 Këshilli i Qarkut ka parashikuar të shtojë në të ardhurat e tij të pritshme, një fond prej 54.5 milion lekësh nga fondet që pret të arkëtojë si rimbursim për shpenzimet që ka kryer për projektet e huaja. Duke qënë se këto fonde celen me kapitull 5 dhe jo me 2, te tabela e parashikimit të të ardhurave në sistemin SMBV, i kemi klasifikuar si grant i brendshëm pas konsultimeve edhe me financat vendore, për efekt rakordimi. Aktualisht,

Këshilli i Qarkut i ka mbyllur të gjitha projektet me financim të huaj dhe do të nisë zbatimin e 2 projekteve të reja. Janë mbyllur 5 projekte të huaja, por disbursimet e fondeve nga donatorët nuk kanë përfunduar ende, pasi po kryhen certifikimet e shpenzimeve. Duke qënë se Këshilli i Qarkut i ka kryer këto shpenzime paraprakisht nga buxheti i vet, pret rimbursimin e tyre nga donatori. Nje pjesë e këtyre fondeve që ishin në llogaritë e projekteve në bankat e nivelit të dytë, u kaluan në thesar për rimbursim shpenzimesh nga ana e Ministrisë të Financave. Pjesa tjetër do të disbursohet nga donatorët. Konkretisht, në vitin 2024 Këshilli i Qarkut ka arkëtuar rreth 11.4 milion lekë nga rimbursimet për projektet e huaja të përfunduara, fonde këto që i janë shtuar buxhetit të vitit 2024 dhe janë celur me kapitull 5 nga thesari, që do të thotë se shpërndarja e tyre në buxhet është bërë sipas vendimeve të Këshillit. Duke qënë se ato nuk u përdorën gjatë vitit 2024, ju bashkuan trashëgimit për vitin 2025. *Edhe pse për efekt bilanci, sipas rekomandimeve të Ministrisë të Financave këto fonde nuk pasqyrohen në llogari të të ardhurave por në llogarinë 106, ato faktikisht janë burim të ardhurash për buxhetin e Qarkut dhe shpërndahen në buxhet sipas vendimeve të Këshillit. Është kjo arsyeja që për vitin 2025 parashikua me kapitull 5 (ashtu si ato celen në momentin e arkëtimit) pikërisht nga rimbursimet. Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 51 607 021 lekë pikërisht nga rimbursimet për projektet e përfunduara. Këto fonde i janë bashkuar trashëgimit për vitin 2026.*

Gjithashtu, duke qënë se Këshilli i Qarkut është në proces të fillimit të zbatimit të 2 projekteve të huaja të reja, për vitin 2026 është parashikuar 1 plan buxheti prej 18.5 milion lekë si financim i huaj, fond i cili parashikon pjesën e parafinacimit. Me kapitull 2 parashikohet vetëm parafinancimi pasi pjesa tjetër e vlerës të projekteve do të disbursohet pasi të jene kryer shpenzimet paraprakisht nga fondet tona buxhetore.

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut të cilat janë marë në konsideratë në hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm janë si më poshtë:

- Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.
- Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korce.
- Pjesëmarrja në Programet ndërkufitare e me gjerë dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.
- Nxitjen e bashkëpunimit midis njësive të qeverisjes vendore të Rajonit, si dhe bashkëpunimin nderrajonal.
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.
- Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integrimit European.

4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Qarkut KORÇË

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

Për Këshillin e Qarkut Korçë të ardhurat e veta përbëhen nga tarifat e DAMT-së dhe kontributi i Bashkive, si dhe për vitin 2025 është planifikuar edhe një burim të ardhurash nga rimbursimi i shpenzimeve të kryera për projektet e huaja të përfunduara. Këshilli i Qarkut nuk arkëton të ardhura nga taksat.

Të ardhurat nga tarifat e DAMT-së nga viti në vit paraqiten me rënie. Për vetë natyrën që kanë është e pamundur të bëhet parashikimi i tyre. Ndërsa për sa i përket të ardhurave nga kontributet e Bashkive, realizimi është gjithmonë në nivele shumë të ulta. Asnjë nga Bashkitë e Qarkut nuk derdh kontributin e vet për llogari të Këshillit të Qarkut edhe pse e kanë përcaktim ligjor. Këshilli i Qarkut ka marë masa duke ju dërguar herë pas here shkresa zyrtare duke ju rikujtuar detyrimet e tyre ligjore, por situata vazhdon të mbetet e njëjtë. Për këtë arsye grupi i punës ka përdorur një logjikë ndryshe nga më përpara me qëllim ritjen e arkëtimeve nga kontributet e bashkive. Duke qënë se deri tani të ardhurat e realizuara nga kontributet e bashkive janë në nivele shumë të ulta, gjykuam një tjetër formë për mbledhjen e tyre që mund të rezultojë më efikase sesa thjesht hartimi i disa marrëveshjeve me bashkitë për derdhje kuotash. Financimet që do të bëjë Këshilli i Qarkut për projekte të ndryshme në të mirë të komunitetit për të gjashta bashkitë pjesë e Qarkut, kryesisht në fushën e turizmit, do të jenë në varësi të kontributit që bashkitë do të derdhin në Qark. Në këtë formë parashikohet të realizohet me sukses zëri I të ardhurave kontribute nga bashkitë dhe është parashikuar në një vlerë dukshëm më të lartë se vitet e mëparshme. Kjo ka bërë që në total të ardhurat e parashikuara për tu realizuar për vitet 2025,2026,2027 dhe 2028 të jenë më të larta se vitet e mëparshme. Sqaruar edhe më sipër. Madje viti 2025 ka një parashikim më të lartë edhe nga vitet 2026, 2027 dhe 2028 pasi mbart edhe pjesën e parealizuar të vitit 2024 që bashkitë u zotuan se do e kalojnë për llogari të qarkut në vitin 2025. Edhe pse është cituar në Ligjin e vetëqeverisjes vendore se bashkitë duhet të parashikojnë në buxhetin e tyre kontribute për Këshillin e Qarkut, ligji nuk i detyron mbi masën e kontributit, kështu që edhe Qarku, përderisa nuk ekziston një detyrim ligjor, e ka të pamundur të bëjë më shumë për arkëtimin e këtyre kontributeve.

Për sa i përket të ardhurave të trashëguara, në vitin 2022,2023,2024, 2025 dhe 2026 janë përfshirë edhe të ardhurat e trashëguara nga një vit më parë. Ndërsa në vitet 2027 dhe 2028 këto të ardhura nuk mund të përfshihen për vetë faktin sepse nuk mund të parashikojmë një informacion të tillë. Për vitin 2026 është përfshirë vetëm 1 pjesë e trashëgimit, pasi vlera totale e trashëgimit do ti shtohet buxhetit pas rakordimit përfundimtar me thesarin. Kjo është edhe arsyeja se pse tavanet për vitin 2027 dhe 2028 dalin më të ulta krahasuar me vitin 2026,2025,2024,2023,2022 . **Vitet 2027 dhe 2028 nuk përfshijnë a)të ardhurat e trashëguara të cilat janë të konsiderueshme për vitin 2025 dhe 2026 dhe b)të ardhurat nga rimbursimet e shpenzimeve për projektet e përfunduara të cilat janë parashikuar vetëm në vitin 2025.** Në vitin 2026 është parashikuar një fond prej 18.5 milion lekësh si burim të ardhurash nga financimet e huaja duke qënë se Këshilli i Qarkut Korçë do të fillojë zbatimin e 2 projekteve me financim të huaj. Pra viti 2026 ka një tavan të ardhurash më të lartë se vitet 2027 dhe 2028 pikërisht për këto arsye.

4.1.1.2 Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Këshilli i Qarkut Korçë nuk arkëton të ardhura nga taksat e ndara

4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 08 date 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”, si dhe bazuar në shkresën e ardhur nga Ministria e Financave mbi transfertën e pakushtëzuar të vitit 2026, tavanet për transfertën e pakushtëzuar janë planifikuar përkatesisht për vitin 2026, 3.6% më e lartë se në vitin 2025, për vitin 2027 me 2.2% krahasuar me vitin 2026, dhe për vitin 2028 me 2.3% krahasuar me vitin 2027. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme shohim se vjen në ritje. Mendojmë se kjo është një rritje relativisht e mirë duke patur parasysh aktivitetet dhe programet e parashikuara për këtë Program Buxhetor Afatmesëm si dhe niveli i ulët i të ardhurave që realizon Këshilli i Qarkut. Transferta e pakushtëzuar kap një peshë të konsiderueshme të buxhetit në total.

4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Këshilli i Qarkut Korçë ka një transfertë të pakushtëzuar sektoriale për të mbuluar ritjen e parashikuar të pagave, përkatësisht 7074 mijë lekë për vitet 2026, 2027, 2028

**Për vitin 2025 është parashikuar edhe një zë të ardhurash : Rimbursime për projektet e huaja të cilat kanë përfunduar dhe shpenzimet për to janë kryer nga buxheti i Këshillit të Qarkut.. Më sipër është sqaruar më me detaje në lidhje me këtë zë të të ardhurave të planifikuara. Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar 51 607 021 lekë pikërisht nga rimbursimet për projektet e përfunduara pasi u arkëtuan të gjitha fondet që kishin mbetur nëpër bankën e nivelit të dytë në llogaritë e projekteve të huaja. Nëpërmjet Ministrisë të Financave, këto fonde kaluan në llogaritë e Qarkut në thesar si rimbursim shpenzimesh. Gjithashtu u arkëtuan edhe disbursimet e mbetura nga projektet e përfunduara. Këto fonde i janë bashkuar trashëgimit për vitin 2026.*

**Për vitin 2026 nuk kemi plan të ardhurash nga rimbursimet e shpenzimeve të projekteve të përfunduara, por kemi plan me kapitull 2 nga financimi i huaj për pjesën e parafinancimeve për 2 projektet e huaja që Qarku do të fillojë të zbatojë.*

2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Qarkut KORÇË për periudhën 2026-2028

Tabela 3, paraqet shpenzimet faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2023 deri në 2028.

Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.

RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK

Ne pamundesi kopjimi te tabelave vec e vec, tabelat i bashkengjithen ketij relacioni dhe jane pjese e tij.

Tabela 4, paraqet shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilin program buxhetor për periudhën 2023-2028

Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike

RAPORTI PBA5: SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT DHE KLASIFIKIMIT EKONOMIK

Ne pamundesi kopjimi te tabelave vec e vec, tabelat i bashkengjithen ketij relacioni dhe jane pjese e tij

Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit FunkSIONAL (Niveli I, II, III i COFOG)

RAPORTI PBA4: SHPENZIMET E NJVQV SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL (NIVELI I, II, III I COFOG) sipas SMBV-se

Ne pamundesi kopjimi te tabelave vec e vec, tabelat i bashkengjithen ketij relacioni dhe jane pjese e tij

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore për tre vitet e ardhme është bërë mbi bazën edhe të orientimeve të Udhëzimit nr. 8 date 28.02.2025.

Niveli i pagave dhe sigurimeve shoqërore është ritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2024, pasi ka mare parasysh edhe ritjen e pagave qe u be me VKM-në nr.503 dt.01.08.2024. Gjithashtu GMS-ja ka marë parasysh edhe ndryshimet në strukturë që u bënë për Këshillin e Qarkut, pasi sipas Ligjit të Buxhetit të vitit 2025, administrata e Këshillit të Qarkut do të shtohet me 3 punonjës. Shpenzimet për paga dhe sigurime për vitin 2026 knë nje rritje shumë të vogël krahasuar me vitin 2025 sepse për vitin 2026 është parashikuar dhe 3% indeksim i pagave sipas inflacionit, nëse do të dalë një vendim i tillë. Parashikimi për këtë zë të shpenzimeve për vitet 2027 dhe 2028 është lënë pak a shumë si në vitin 2026.

Shpenzimet operative janë planifikuar mbi bazën e normativave të miratuara, mbi bazën e realizimit faktik të tyre në periudhat e mëparshme si dhe mbi bazën e aktiviteteve pjesë e të cilave do të jetë Këshilli i Qarkut për vitet në vazhdim. Ne këtë zë është patur parasysh ulja e nivelit të borxhit të trashëguar sipas planifikimit. Shpenzimet operative janë më të larta për vitet 2026,2027,2028 krahasuar me vitet 2022 dhe 2023. Buxheti, që pej viti 2024 është hartuar disi ndryshe nga vitet e mëparshme. Fokusi është vënë në më shumë projekte që do të kene një impakt rajonal dhe që do i shërbejnë një komuniteti të gjerë në fushën e turizmit, kulturës, mbështetjes sociale etj. Kjo ka bërë që strukturës buxhetore të Qarkut ti shtohen disa funksione të tjera që prej vitit 2024, si programi për mbështetje dhe dhe zhvillim ekonomik, programi i përkujdesit social, trashëgimia kulturore,eventet artistike dhe kulturore. Të gjitha këto projekte do të jenë më shumë në formën e shpenzimeve operative, **për këtë arsye zëri shpenzime operative është më i lartë nga vitet e mëparshme.** Struktura e buxhetit që nga viti 2024 ka ndryshuar disi nga vitet e mëparshme, falë mënyrës të re të konceptimit dhe për të qënë sa më afër në shërbim të kumunitetit të të gjithë Rajonit. Shpenzimet operative për vitet 2027 dhe 2028 janë më të ulta krahasuar me vitin 2026 për vetë faktin se këto 2 vite kanë një tavan më të ulët të të ardhurave duke qënë se nuk kanë as plan nga parashikimi dhe as nga financimi i huaj ashtu sic ka viti 2026.

Shpenzimet për investime, ndryshe nga vitet e mëparshme janë_ menduar të shtrihen në ato fusha që do të kenë një impakt më të madh rajonal, pra që do ti shërbejnë rajonit në tërësi. Gjithashtu është menduar që këto investime do të jenë edhe në varësi të kontributeve financiare që Bashkitë do të japin për Këshillin e Qarkut. Kryesisht, në përgjigje edhe të kërkesave të bashkive, këto investime prekin fushën e turizmit dhe jo vetëm. Shohim se parashikimi për vitet 2027 dhe 2028 është më i ulët, jo sepse nuk do të jetë fokusi në këto zëra, por sepse 3 vitet e ardhshme nuk përfshijnë trashëgimin, ndërkohë që viti 2026 ka një fond të trashëguar të konsiderueshëm i cili është shpërndarë kryesisht në investime, investime të cilat ishin planifikuar për vitin 2025 dhe nuk u realizuan.

Në vitin 2025 dhe 2026 Këshilli i Qarkut ka parashikuar edhe financimin si kontribut direkt të Bashkisë, te disa projekteve sipas kërkesave të bashkive. Kjo mënyrë financimi është bërë bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen vendore si dhe në Ligjin e Financave Vendore, ku sipas tyre njësitë e qeverisjeve vendore mund të marrin dhe japin kotribute financiare midis tyre bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që lidhin mes tyre. Është aplikuar kjo formë financimi për Bashkitë duke qënë se Këshilli i Qarkut ka edhe kufizimeve për sa i përket burimeve njerëzore për ndjekjen e gjithë procedurave të nevojshme.

Shpenzime për pjesëmarrje në Programet IPA me projekte të fituara me fonde të Bashkimit Europian. Në vitin 2023 ka përfunduar financimi i tre projekteve në proces pasi dy ishin mbyllur që në vitin 2022. Aktualisht Këshilli i Qarkut është në process aplikimi në projekte të reja të huaja dhe ka fituar 2 projekte : HEALTH4ALL dhe GST GERA. Këto 2 projekte do të fillojnë të zbatohen në vitin 2026. Për këtë arsye Këshilli i Qarkut ka planifikuar fonde për të dyja këto projekte. Ka planifikuar edhe fonde me kapitull 2, financim i huaj, për pjesën e parafinancimit, edhe fonde me kapitull 5 nga trashëgimi. Është e domosdoshme që për ecurinë normale të projekteve të huaja, institucioni të planifikojë fonde nga buxheti i tij sepse sipas marrëveshjeve të nënshkruara, pala e huaj i disburson fondet vetëm pas realizimit të shpenzimeve nga institucioni zbatues i projektit dhe certifikimit të tyre. Vetëm pas këtij momenti donatori disburson fondin dhe institucioni e arkëton këtë fond si rimbursim të shpenzimit që ka kryer paraprakisht nga buxheti i tij. Duke qënë se është menduar se projektet HEALTH4ALL dhe GST GERA do të shtrihen përgjatë 2 viteve, janë planifikuar fonde edhe për vitin 2027. Këto 2 projekte janë celur si projekte investimesh me financim të huaj në PSHP4. Duke qënë se sistemi SMBV nuk të lejon të hedhesh shpenzime korrente me kapitull 5(602) në PSHP4, këtu u hodhën vetëm shpenzimet kapitale me kapitull 2 dhe 5, ndërsa shpenzimet korrente u hodhën në PSHP5, në disa prej produkteve standarte. Koncretisht në produktet V457AAA dhe V014AAE. Projektet me financim të huaj kanë edhe shpenzime korrente edhe shpenzime kapitale.

Këshilli i Qarkut është aktiv në Programet e celura nga Bashkimi Europian për të krijuar mundësinë e thithjes së sa më shumë fondeve për zhvillimin e Rajonit.

Në total buxheti për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 është parashikuar si më poshtë:

Viti 2026	222765 mijë lekë
Viti 2027	112389 mijë lekë
Viti 2028	116549 mijë lekë

Shpenzimet që do të rrjedhin nga transfertat e kushtëzuara nuk janë pjesë e tabelave.

*Ritheksojmë edhe një herë se buxheti i vitit 2025 dhe 2026 është dukshëm më i lartë krahasuar me vitin 2027 dhe 2028. Viti 2025 përfshin trashëgimin nga viti 2024 si dhe planin e të ardhurave nga rimbursimi i projekteve të huaja të përfunduara, ndërsa viti 2026 përfshin trashëgimin e vitit 2025 si dhe një plan të ardhurash nga financimi i huaj. Gjithashtu edhe buxheti i vitit 2026 ka një diferencë të konsiderueshme krahasuar me vitet 2025 dhe është më i ulët pasi në vitin 2025 Këshilli i Qarkut ka arkëtuar të gjithë fondet nga rimbursimet e shpenzimeve për projektet e huaja të përfunduara.

4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR

Shpenzimet për investime në vazhdim, ndryshe nga vitet e mëparshme janë menduar të shtrihen në ato fusha që do të kenë një impakt më të madh rajonal, pra që do të shërbejnë rajonit në tërësi. Gjithashtu është menduar që këto investime do të jenë edhe në varësi të kontributeve financiare që Bashkitë do të japin për Këshillin e Qarkut. Fokusi është vënë në investimet në fushën e turizmit, apo dhe të trashëgimisë kulturore, fusha të cilat kanë potencial për të zhvilluar të gjitha Bashkitë e Qarkut tonë. Për vitin 2025 2026 2027 dhe 2028 Projektet e Investimeve i kemi në Raportin PBA8.

Duke qënë se pjesa më e madhe e investimeve të planifikuara për vitin 2025 nuk u realizuan për shkak të problematikave të ndryshme dhe për shkak të kufizimeve që mund të ketë Këshilli i Qarkut qoftë në burime njerëzore apo qoftë edhe në realizimin e procedurave, një pjesë e tyre janë miratuar me Vendim Këshilli që të kalojnë në formën e kontributeve financiare me destinacion, për Bashkitë, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara mes Këshillit të Qarkut dhe Bashkive, në mënyrë që Bashkitë të realizojnë vetë objektet e investimit për të cilat është rënë dakord. Një pjesë e këtyre investimeve janë alokuar përsëri në buxhetin e vitit 2026, dhe një pjesë janë në proces.

Gjatë vitit 2025 u mbyllën projektet e investimeve TIP: -Pajisje për qendrën Infopoint Maliq si dhe Rivitalizimi i Prespës të Vogël. Gjithashtu u mbyllën edhe projekt-studimet me Bashkinë Pustec si dhe Projekt-studimi me Bashkinë Maliq për rehabilitimin e lagjes Muze. U përfundua edhe projekti i investimit për ngritjen e qendrës të përpunimit të të dhënave bazuar në inteligjencën artificiale në Universitetin Fan S Noli. Është në proces “Ndërtimi i Muzeut të Dritëro Agollit”, i cili do të përfundojë në vitin 2026.

Investimet e tjera për vitin 2026 janë parashikuar bazuar në kërkesat që kanë ardhur nga Bashkitë e Qarkut.

Investimet për vitet 2027 dhe 2028 nuk mund të parashikohen në projekte investimesh të detajuara pasi ato janë edhe në varësi të kërkesave dhe prioriteteve që vijnë nga bashkitë e Qarkut.

5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE

Në PBA-në 2025-2027, buxheti total i Qarkut KORÇË kishte 11 programeve të shpenzimeve. Ndërkohë 2 programe (05100 dhe 06370) kanë përfunduar pasi lidheshin me projektet me financim të huaj . Gjithashtu edhe programi 09230 apo 04520 nuk kanë plan për vitin 2025 apo për vitet në vazhdim, por i janë shtuar PBA-së 2025-2027 për shkak të faktit të vitit 2023 apo 2024. Gjithashtu edhe programi 09120 ka vetëm një fond prej 22 mijë lekësh që vjen si rezultat i mbetjes të palikujduar të nje mbikqyrjeje objekti në që vitin 2019, pasi operatori nuk priste faturë. Programe funksionale janë vetëm 6. Kjo për sa i përket vitit 2025.

Për sa i përket viteve 2026 2027 dhe 2028, ku Qarku korçë do të buxhetojë sipas metodologjisë të re duke filluar nga viti 2026, PBA-ja është hartuar bazuar në kjo metodologji, sipas të cilës Këshilli i Qarkut Korçë ka vetëm 1 program buxhetor, AA015. Ky program ka disa qëllime dhe objektiva të cilat janë të lidhura me funksionet që qarku ushtron.

Ky seksion i dokumentit të PBA-së paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Qarkut. Çdo nën-seksion (3.1 deri në 3.X) paraqet informacionin e performancës të planifikuar dhe kostot përkatëse për një program. Për secilin program informacioni i paraqitur konsiston në:

- Shpenzimet totale të programit sipas kategorisë ekonomike (paga dhe sigurime, shpenzime korente dhe shpenzime kapitale) për dy vitet e kaluara (fakti), vitin aktual (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme (parashikimi);
- Politika e Programit (qëllimet e politikës së programit, objektivat e programit dhe treguesit përkatës të performancës);
- Planet e shpenzimeve të Produkteve të Programit;
- Projektet e investimeve; dhe
- Të dhëna dhe statistika të përgjithshme të programit.

Tabela 5, paraqet informacion mbi shpenzimet totale të programit sipas kategorive ekonomike për dy vitet e mëparshme (faktin), vitin aktual buxhetor (buxheti fillestar dhe i pritshmi) dhe tre vitet e ardhshme të PBA-së (parashikimi).

Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike

RAPORTI PBA3: SHPENZIMET E NJVQV DHE PROGRAMIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK (SMBV)

Ne pamundesi kopjimi te tabelave vec e vec, tabelat i bashkengjithen ketij relacioni dhe jane pjese e tij

5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në Tabelën 6, duke artikuluar qëllimet e politikës së

programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të performancës për çdo vit të PBA-së.

Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

RAPORTI PBA6: DEKLARATA SË POLITIKËS SË PROGRAMIT(SMBV)

Ne pamundesë kopjimi të tabelave vec e vec, tabelat i bashkëngjithen këtij relacioni dhe janë pjesë e tij

5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Ky nënseksion, ofron informacion mbi planet e ofrimit të shërbimeve të programeve dhe kostot përkatëse. Për secilin Objektiv të Politikës së Programit, paraqitet informacion për produktet që do të kontribuojnë në arritjen e këtyre objektivave. Informacioni për produktet përfshin emrin e produktit, përshkrimin e produktit, sasinë e planifikuar, shpenzimet totale dhe shpenzimet për njësi të produktit.

Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit

RAPORTI PBA7: SHPENZIMET E PRODUKTEVE TË PROGRAMIT (SMBV)

Ne pamundesë kopjimi të tabelave vec e vec, tabelat i bashkëngjithen këtij relacioni dhe janë pjesë e tij.

Me ndryshimin e strukturës të buxhetit për vitin 2024, domosdoshmërisht ndryshoi edhe struktura për vitin 2025, 2026 2027 dhe 2028. U shtuan programe të reja buxhetore dhe ndryshoi fokusi për disa programe.

Me futjen e Qarkut në zbatimin e metodologjisë të re në vitin 2026, ndryshoi përsëri struktura buxhetore. Programi buxhetor do të jetë një i vetëm, por funksionet e Qarkut do të vazhdojnë të jenë ato që kanë qënë edhe më përpara, dhe në varësi edhe të kushteve apo nevojave që mund të lindin, mund edhe të shtohen apo hiqen funksione të caktuara nëpërmjet shtimit apo heqjes të produkteve.

Për vitet 2026, 2027 dhe 2028 janë planifikuar produktet si më poshtë:

- Shërbimi i stafit të administrim dhe menaxhim (01110) V111AAA
- Mirëmbajtja e infrastrukturës dhe funksionimi i aparatit (01110) V111AAD
- Akte të miratuara nga Këshilli (01110) V111AAB
- Përbushja e detyrimeve gjyqësore (01110) V111AAG
- Nëpunës të trajnuar (01110) V111AAH
- Fondi rezerve V491AAA
- Promovimi i turizmit V476AAB
- Plani Strategjik i zhvillimit V413AAA
- Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor V422AAD
- Promovimi i trashëgimisë kulturore (08220) V822AAD
- Objekte të trashëgimisë Kulturore të mirëmbajtura V822AAC
- Objekte të arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale V923AAB
- Shërbim transporti publik V457AAA
- Individë AK që përfitojnë trajtim V014AAE
- Persona që përfitojnë kujdesin social V014AAB

Kostimi i këtyre produkteve është bërë duke pasur parasysh faktin e vitit 2025 si dhe ecurinë aktivitetëve të planifikuara gjatë këtyre viteve të fundit.

5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit

Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit

RAPORTI PBA8: PROJEKTET E INVESTIMEVE (SMBV)

Ne pamundësi kopjimi të tabelave vec e vec, tabelat i bashkëngjithen këtij relacioni dhe janë pjese e tij.

Projektet e investimeve të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit 2025 dhe që janë planifikuar përsëri për vitin 2026, janë celur si projekte të reja në PSHP4 për vitin 2026, pasi ato ishte planifikuar që të mbylleshin brenda vitit 2025, por nuk u bë e mundur.

5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Tabela 9. Informacione bazë mbi Programin

Këshilli i Qarkut nuk disponon të dhëna statistikore më të specifikuara.

Konkluzione

Kjo është faza e tretë e PBA-së 2026-2028, e cila është hartuar sipas metodologjisë të re, pra buxheti me bazë produktin. Programi për Këshillin e Qarkut është një i vetëm sipas kësaj metodologjie. Ky program konsiston në disa qëllime dhe objektiva të cilat janë të lidhura nëpërmjet produkteve, me funksionet që Qarku do të ushtrojë.

PBA-ja 2026-2028 përfundimtare është bazuar në PBA-në e rishikuar 2026-2028. Janë bërë ndryshimet në vitin 2025 sipas rishikimeve që ka pësuar buxheti. Tavanet janë ato të miratuara me vendimin e Këshillit të Qarkut nr.03 dt.21.03.2025. Si e theksuam edhe më sipër tavanet për vitet 2027 dhe 2028 janë dukshëm më të ulta se viti 2026 pasi nuk përfshijnë trashëgimin si dhe fond nga rimbursimi i shpenzimeve të projekteve të huaja të përfunduara. Gjithashtu për vitin 2026 është parashikuar një plan buxheti me kapitull 2 nga financimet e huaja prej 18.5 milion lekësh (vlera e parafinancimit të 2 projekteve të huaja që do të fillojnë të zbatohen në vitin 2026), GST GERA dhe HEALTH4ALL. Për këto 2 projekte të huaja Këshilli i Qarkut ka planifikuar fonde edhe nga buxheti i vet, fonde për shpenzime korrente si dhe fonde për shpenzime kapitale, pasi sic dihet tashme, fondet nga donatorët disbursohen vetëm pas kryerjes paraprake të shpenzimeve nga fondet buxhetore.

Mendohet që në të ardhmen fokusi do të jetë në projekte të shumta të cilat do ti shërbejnë të gjithë rajonit, në aspekte dhe fusha të ndryshme si sociale, kulturore, zhvillimore etj, dhe që do të jenë të ndara sipas produkteve sipas udhëzimit të Ministrisë të Financave mbi zbatimin e metodologjisë të re për bashkitë dhe qarqet pilot. Në këtë program janë mbajtur parasysh kërkesat e UMF Nr. 23 dt. 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, UMF Nr. 8 dt. 28.02.2025 dhe nr.19 dt.10.07.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028”, Vendimi i Këshillit të Qarkut mbi miratimin e Kalendarit të hartimit të PBA-së 2026-2028 si dhe buxhetit vjetor, etj. Këtë vit PBA-ja u hartua, sipas udhëzimit, në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe sipas metodologjisë të re.

Në planifikimin e të ardhurave të veta, për periudhën 2026-2028, GMS u mbështet në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.68, datë 24.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, duke mbajtur parasysh:

1. Realizimin e të ardhurave nga kuota e anteaesisë nga gjashtë bashkitë përbërse të Qarkut.
2. Realizimin e të ardhurave nga shërbimet që ofron Këshilli i Qarkut. (tarifa vetëm nga DAMT-ja)

Për vitin 2025 është planifikuar edhe një burim të ardhurash nga rimbursimet e shpenzimeve që janë kryer për projektet me financim të huaj të cilat janë mbyllur, por fondet nuk janë disbursuar të gjitha nga ana e donatorëve. (sqsuar si më sipër)

Për vitin 2026 është planifikuar një burim financimi me kapitull 2, financim i huaj, si më sipër sqaruar.

Ky Program Buxhetor, pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar, të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që

Qarku do të ketë në dispozicion, për të financuar shpenzimet e tij. Në shpenzimet e planifikuara, janë mbajtur parasysh shpërndarja e tyre sipas funksioneve të cilat identifikohen nëpërmjet kodit të produkteve, ku janë parashikuar shpenzimet për administratën e Këshillit të Qarkut, shpenzime për përkujdesin social, për mbështetjen për zhvillim ekonomik, për shërbimet publike vendore etj. Në PSHP5 janë celur edhe 2 produkte të cilat lidhen me shpenzimet korrente të planifikuara për 2 projektet e huaja, nga fondet e veta buxhetore, duke qënë se SMBV-ja nuk të krijon mundësinë e shpërndarjes të shpenzimeve korrente për projektet e huaja me kapitull 5 ose 1, në PSHP4. Këto shpenzime janë alokuar sipas projekteve të huaja që do të zbatohen, pasi sipas marrëveshjeve të nënshkruara, fondet nga donatorët disbursohen pas realizimit të shpenzimeve nga fondet tona buxhetore dhe pas certifikimit të tyre.

Këto shpenzime janë parashikuar me kapitull 5, pikërisht nga fondet që kanë ardhur nga rimbursimet e shpenzimeve të kryera deri tani për projektet e huaja që janë mbyllur. Ky zë të ardhurash është planifikuar në buxhetin e vitit 2025 me kapitull 5 dhe duke qënë se der në fund të vitit 2025 këto fonde u arkëtuat, ato janë bërë pjesë e trashëgimit që është planifikuar për vitin 2026. Konkretisht janë celur si rimbursime vetëm 51 607 021 lekë të cilat i janë shtuar buxhetit të Qarkut në vitin 2025 dhe gjithashtu janë planifikuar në fondi i trashëgimit për vitin 2026. Mbi bazën e këtyre vlerësimeve institucioni ka përcaktuar tavanet e shpenzimeve të PBA-së, ku në parashikimin sipas programeve, GMS, pati parasysh:

Fushat ose sektorët që kanë nevojë më shumë për mbështetje dhe që një ndërhyrje në këto sektorë do të kishtë një impakt për të gjithë rajonin në tërësi.

Në totali fondi për investime kap përkatesisht rreth 52% të totalit të shpenzimeve për vitin 2025, (sic u përmend edhe më sipër viti 2025 ka një vlerë më të madhe nga vitet 2026 2027 dhe 2028 për arsye të sipërpërmendura). Gjithashtu në vitin 2026 do të mbyllet edhe të gjitha investimet që nuk u realizuan dot në vitin 2025.

Ndërkohë % e investimeve ndaj totalit të buxhetit është 46.7% për vitin 2026, dhe 34.2% për vitin 2027, dhe 34.3% për vitin 2028, tregues ky mjaft i rëndësishëm. Viti 2026 ka një % më të lartë të investimeve pasi sic edhe e kemi përmendur më sipër ka të parashikuar një plan buxheti për 2 projekte me financim të huaj të cilat konsistojnë kryesisht në shpenzime kapitale. Për vitin 2027 dhe 2028, përqindja që ze zëri i investimeve është më e ulët se viti 2025, për arsye që i kemi përmendur më sipër, por përsëri është e konsiderueshme. Fokusi i investimeve tanimë do të jetë kryesisht në fushën e turizmit apo hartimit të projekteve studimore që do të shërbejnë bashkive të Qarkut për ti vënë në zbatim.

Shpenzimet për personelin, parashikimi u bë në mbështetje të numrit të punonjësve të planifikuar me ligj si dhe nivelit të pagave të miratuara me VKM. Në parashikimin për shpenzime operative u mbështetëm në realizimin e shpenzimeve të viteve të kaluara dhe parashikimin e shpenzimeve administrative më të domosdoshme për funksionimin e Institucionit. Gjithashtu me ndryshimin e strukturës të buxhetit në vitin 2024, shtimi i programeve të reja (me metodologjinë e re, funksione) konsiston pikërisht në realizimin e shumë aktiviteteve me impakt rajonal që në vetvete janë shpenzime operative, duke bërë që në total ky zë të jetë më i lartë për vitet në vazhdim. Shpenzimet operative zënë 29.8% të buxhetit për vitin 2026, 35.5% për vitin 2027 dhe 36.5% për vitin 2028. Shpenzimet operative janë ritur disi krahasuar me vitin 2023 pasi vetë mënyra e re e strukturimit të buxhetit përmban më shumë zëra të shpenzimeve operative të shpërndara sipas programeve buxhetore. Viti 2026 rezulton

me shpenzime më të ulta operative dukë qënë se plani buxhetor që kemi shtuar me kapitull 2 prej 18.5 milion lekësh, konsiston kryesisht në shpenzime për investime. Pra ne uljen e këtij rezultati ndikon shtimi i planit të financimeve të huaja.

Duhet theksuar se për herë të parë në vitin 2025 është bërë pjesë e buxhetit edhe parashikimii për realizimin e të ardhurave nga rimbursimet e shpenzimeve për projektet me financim të huaj të përfunduara, fonde të cilat u realizuan brenda vitit 2025.(Sqaruar më sipër)

Ky Program buxhetor afatmesem është i balancuar(te ardhurat= shpenzimet).

Detyrimet e prapambetura: Qarku Korçë nuk ka detyrime të prapambetura që lidhen me vendimet gjyqësore të formës të prerë. Gjendja aktuale e stokut të borxhit është 280 mijë leke të ndara si më poshtë:

- Mallra dhe shërbime 160 mijë lekë
- Te tjera 120 mijë lekë

Të gjitha detyrimet i takojnë periudhës para vitit 2015 në një kohë kur Institucioni ka kaluar vështirësi financiare, të trajtuara shumë herë në Këshillin e Qarkut. Një pjesë e mirë e këtyre detyrimeve të ngelura ka mungesë dokumentacioni dhe interesimi nga pala kreditore dhe për këtë arsye likuidimi i tyre është i vështirë. Institucioni ka planifikuar amortizimin e borxhit brenda Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028. Këshilli i Qarkut ka marrë të gjitha masat për zbatimin e këtij programi dhe mos lejimin e borxheve të krijuara rishtas.

Risqet fiskale: Risku kryesor financiar me të cilin përballlet Këshilli i Qarkut është mosrealizimi i të ardhurave të parashikuara. Të ardhurat e veta zene një pjesë të vogël të totalit të të ardhurave për vetë faktin se Këshilli i Qarkut arkëton vetëm tarifat e DAMT-së, shumë rrallë tarifa të urbanistikës dhe kontributet e Bashkive. Këto të ardhura janë në nivele të ulta realizimi pasi Bashkitë e Qarkut, edhe pse e kanë përcaktim ligjor, vazhdojnë të mos derdhin kontributet e tyre për llogari të Këshillit të Qarkut. Gjithashtu mund të përmendim edhe një risk tjetër që lidhet me projektet me financim të huaj. Duke qënë se këto projekte financohen fillimisht nga fondet buxhetore dhe më pas pas certifikimit të shpenzimeve donatori bën disbursimin, ekziston risku i humbjeve nga kurset e këmbimit, pasi projektet e huaja janë në euro, dhe shpenzimet kryhen në lekë.

PBA-ja paraparak do të publikohet në faqen web të Këshillit të Qarkut www.qarkukorce.gov.al, pas miratimit në Këshill.

Anëtarët e ekipeve të menaxhimit të programeve.

Mimoza Shuli

Elona Mano

Doriana Tego

Flodi Mero

Mariela Alickolli

Paola Lara

Mirela Shkurti

Niko Janaqi

Sekretar i GM-së

Oljona Beqiraj

Koordinator i GMS-së

Mimoza Shuli

KRYETARI
Petrika Tollkuçi